

Çfarë mund të bëni që të parandaloni Sjellje të Rrezikëshme Online të Fëmijës tuaj?

- Komunikoni dhe flitni me fëmijën për rrezikun e mundshëm online.
- Shpenzoni kohë me fëmijën tuaj online. Mësoni prej tyre për destinacionet që ata pëlqejnë online.
- Mbajeni kompjuterin në një mjedis të përbashkët dhe jo në dhomën e gjumit të fëmijës.
- Përdorni kontrollet e prindit (parental controls), që ofrohen nga kompanitë e shërbimit online, dhe/ose programe bllokuese. Përdorimi i dhomave të kuvendimit (chat rooms), veçanërisht duhet të monitorohet imtësisht. Ndërsa prindërit duhet t'i përdorin këto mekanizma, ata nuk duhet të mbështeten plotësisht vetëm në ato.
- Gjithmonë ruani të drejtën e përdorimit të llogarisë online të fëmijës dhe kontrolloni herë pas here emailin e tij/saj. Bëni kujdes se fëmija mund të kontaktohet edhe nga posta e rregullt (U.S. Mail). Shpjegojani fëmijës arsyen pse ju duhet të keni akses në llogarinë e tij.
- I mësoni fëmijës përdorimin e përgjegjshëm të burimeve online.
- Mësoni se çfarë masa mbrojtëse përdoren në kompjuterat e shkollës, të bibliotekave publike dhe në shtëpitë e shokëve të fëmijës tuaj. Këto janë vendet, jashtë kontrollit tuaj normal, ku fëmija juaj mund të gjendet pre e abuzuesve online.
- Kuptojeni, se edhe në rast se fëmija juaj është pjesëmarrës me dëshirë në ndonjë formë të veprimeve seksuale, ai/ajo nuk janë fajtorë, ai/ajo janë viktimë. Abuzuesi gjithmonë mban përgjegjësi të plotë, për veprimet e tij, ose të saj.
- Udhëzoni fëmijën tuaj që:
 - Kurrë të mos organizojë takim vetëm për vetëm me dikë që e ka takuar online;
 - Kurrë të mos postojë fotografi të tij në Internet ose në shërbimet online, për persona të cilët nuk i njeh personalisht;
 - Kurrë të mos japë informacione private, të tilla si emrin, adresën e shtëpisë, emrin e shkollës, ose numrin e telefonit;
 - Kurrë të mos shkarkojë foto nga burime të panjohura, pasi këto janë mundësi që të jenë figura me përmbajtje seksuale;
 - Kurrë të mos përgjigjet ndaj mesazheve ose postimeve, të cilat janë sugjestionuese, të pahijëshme, agresive, ose ngacmuese;
 - that whatever they are told on-line may or may not be true.